



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primar / Dateduar Punëno / Pristato Received / Delivered	28.03.2022	2	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednitsa Org / Unit	Nr Prot No Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHMSHAK	1619/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

Anr.108/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.108/2022 të datës 10.02.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike „ kundër vlerësimit të punës për vitin 2021”, dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.03.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. **ANULOHE**T vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën janar-dhjetor për vitin 2021, për ankuesen
- II. **OBLIGO**HET Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi, t'i ndërmarr të gjitha veprimet me qëllim që ankueses t'i bëhet rivlerësimi i rezultateve të punës për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021.
- III. **OBLIGO**HET Kryetari i Komunës së Gjakovës, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet në sipërkëtë pikë II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Gjakovës sipas Akt emërimit me nr.01-112/02-37391 të datës 13.12.2021 i nxjerrë sipas Vendimit me numër 01-112/02-24795/21 për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publik në vendin e punës „Udhëheqëse e Sektorit për Gjendje Civile” me datë 28.01.2021 ka pranuar formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 me notën e përgjithshme 2.6, nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Lidhur me këtë ankuesja ka parashtruar

komentet në formularin e vlerësimit për rezultatet e punës për vitin 2021 dhe gjithashtu dhe mbikëqyrësi i saj i fundit ka përshkruar arsyen e vlerësimit të saj me notën e përgjithshme 2.6.

Ankuesja, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, ka parashtruar ankesë me datë 10.02.2022 me numër protokollit 654/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 i është bërë vetëm nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i fundit me të cilin ka punuar vetëm 20 dite pune të vitit 2021, dhe nuk i është bërë vlerësim nga dy mbikëqyrësit paraprak, po ashtu ajo pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 konkretisht tek përmbushja e objektivave të punës është bërë në kundërshtim me nenin 7 dhe 8 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 18.02.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës e cila me datë 09.03.2022 e ka dërguar në Këshill me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, si dhe me datë 14.03.2022 ka dërguar prova shtesë përmes formës elektronike. Me datë 23.03.2022 Këshilli ka kërkuar prova shtesë e cila në të njëjtën ditë ka dërguar provat e kërkuar në formë elektronike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 654/2022 e datës 10.02.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.108/2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategoritë drejtuese të mesëm, të ulët dhe profesionale për vitin 2021; Përgjigje në ankesë e datë 09.03.2022; Akt emërimi i datë 13.12.2021 sipas deklaratimit të statusit të zyrtarëve publike; Përshkrimi i detyrave të punës i datë 14.01.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategoritë drejtuese të mesëm, të ulët dhe profesionale i datës 29.01.2021; E-maili i datës 23.02.2022; E-mail i datës 24.02.2022; E-mail i datës 23.02.2022; Fletëparaqitje për komision disiplinor i datës 18.08.2014; Njoftim për vërejtje me shkrim e datës 05.08.2015; Vërejtje me shkrim e datës 04.08.2015; Vërejtje e datës 16.06.2021; Email i datës 19.04.2021 Ankesë; E-mail i datës 28.04.2021 Ankesë; Kërkesë e datës 28.04.2021 për fillimin e procedurës disiplinore; Njoftim i datës 21.04.2021; Email i datës 27.11.2020 kërkesë; kopje e mbështjellëse e lëndës e datës 29.04.2021; Prova shtesë për mes E-mailit zyrtar të datës 14.03.2022, dhe të datës 23.03.2022, me shkresat e bashkëngjitura, Vendimi i datës 05.06.2021, Vendimi i datës 01.10.2020, Vendimi i datës 22.12.2021, formularët e nxjerre nga sistemi SIBMNJ, për planin e punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankueses të *ktthehet në rivlerësim, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që ankuesja në ankesën e saj të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 10.02.2022 ka theksuar që formularin e vlerësimit për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021, e ka pranuar me datën 28.01.2022, ndërsa ankuesja me datë 31.01.2022 e ka nënshkruar formularin e vlerësimit të punës duke i dhënë

edhe komentet lidhur me vlerësim të punës lidhur me realizimin e planit profesional të objektivave dhe aktiviteteve të punës po ashtu ankuesja e ka kontestuar se vlerësimi i punës për vitin 2021 është bërë nga personi jo kompetente pasi që nga data 1 janar deri me datë 4 korrik 2021 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i saj ka qenë z. [] Drejtor i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative, nga data 5 korrik deri me datë 21 dhjetor 2021 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i saj ka qenë [] ndërsa nga data 22 dhjetor deri me datë 31 dhjetor 2021 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i saj ishte [] ku ky i fundit e ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 për ankuesen edhe pse ankuesja ka punuar me të vetëm 10 dite.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar pasi që vlerësimi i punës për ankuesen [] për vitin 2021 është bërë nga personi jo kompetent rrjedhimisht gjendja faktike dhe ligjore është vërtetuar edhe me e-mailin e datës 23 mars 2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës si dhe Vendimin me numër 01-Nr.11202-22235 të datës 01.10.2020 dhe Vendimin me numër Nr. 01-112/01-38391 të datës 22.12.2021 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës me të cilët janë emëruar Drejtoret e Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative. Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konkretisht faktin se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses është mbikëqyrësi i fundit i cili ka marrë pozitën "Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative", në Komunë të Gjakovës, nga data 22.12.2021 sipas Vendimit Nr.01-112/01-38391 të datës 22.12.2021, Kolegji konstaton se nuk mund të jetë objektiv në vlerësimin e rezultateve të punës për tërë periudhën e vitit 2021 sepse në bazë provave të lëndës është konstatuar se ankuesja paraprakisht ka pasur edhe dy mbikëqyrës të drejtpërdrejtë, nga të cilët ankuesja nuk është vlerësuar respektivisht nuk është përfshirë vlerësimin për këto dy periudha nga mbikëqyrës të ndryshëm, ku prej datës 01.01.2021 deri me datë 04.07.2021, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka qenë [] nga data 05.07.2021 deri me datë 21.12.2021 mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka qenë [] dhe së fundmi nga data 22.12.2021, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka qenë [] e që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: "5. Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse", si dhe në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: "2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues", e që në rastin konkret Mbikëqyrësi i fundit nuk i ka marrë për bazë këto dispozita, gjatë fazës së vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021 për ankuesen, sepse vlerësimi për nëpunësit përbëhet prej fazave, si përcaktimin e objektivave, vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar dhe vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejtë analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës konkretisht, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i qëndrueshëm sepse nuk ka asnjë dëshmi që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses në fund të periudhës së vlerësimit ka ftuar ankuesen për të

diskutuar për realizimin e objektivave dhe rezultateve të arritura, ashtu siç parashihet me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: *“Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; vlerësimin (notimi) e objektivave”*, po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësi është takuar me ankuesen gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Po ashtu ankuesja ka kontestuar të gjithë kapitujt e vlerësimit nga I-III, sepse vlerësimi i rezultateve të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakte sepse mos përfshirja e arritjes së objektivave për ankuesen në bazë të detyrave të punës nuk është bazuar në raportet dhe aktivitetet e saj në punë, ku në ë bazë të provave, në vlerësim tek objektivat nuk janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe detyrat e saj të punës, e që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1, 2, 3,4,5,6 dhe 7, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, si dhe duke u bazuar në përmbajtjen e vlerësimit të rezultateve në punë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se: *“ 1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit - sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësi në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë”*, andaj vlerësuesi/eprori aktual nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankueses për vitin 2021, ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses konkretisht Drejtor i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme 2.6 tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesja me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njërës prej objektivave dhe detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj tre mbikëqyrësit e saj te drejtpërdrejtë janë të obliguar që ankueses ti bëjnë rivlerësimin e rezultateve të punës për periudhën kur ata kanë qenë mbikëqyrës të saj, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Kryetarin e Komunës së Gjakovës, si udhëheqësin më të lartë administrativ që të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi, ndërsa Udhëheqësit e drejtpërdrejtë të ankueses në pajtim me të gjeturat e këtij vendimi të bëjnë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 për ankuesen gjeçësisht rivlerësimi i rezultateve të punës të behet nga tre mbikëqyrësit e saj, konkretisht për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datën 04.07.2021, rivlerësimi i rezultateve të punës të behet nga nga data 05.07.2021 deri me datë 21.12.2021 rivlerësimi i rezultateve të punës të bëhet nga dhe nga data 22.12.2021 deri me datë 31.12.2021, rivlerësimi i rezultateve të punës të behet nga si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Anr.108/2022.

Zyle Millaku-Gojnovci

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses*
- *Kryetarit të Komunës së Gjakovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunë të Gjakovës,*
- *Arkivit të KPMSHCK.*